



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1111/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shpërndarjes së materialit zgjedhor në hapësirë publike, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.11.2021, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pazuar ankesa A.nr.1111/2021 e datës 11.11.2021, e paraqitur nga Subjekti Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shpërndarjes së materialit zgjedhor në hapësirë publike, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021

A r s y e t i m

Me datën 11.11.2021, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datën 11.11.2021 në ora 10:00, aktivistët e subjektit të tyre kanë vërejtur se Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka shpërndarë material zgjedhor në kundërshtim me nenin 33 pika b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në vazhdim të ankesës pretendojnë se i njëjti ka shpërndarë materialin zgjedhor në hapësirë të palejuar, në hapësirë të brendshme të banesave kolektive-ndërtesave, godinave, në lagje të ndryshme të Prishtinës dhe këto shihen në fotot e bashkangjitura si dëshmi lidhur me ankesat. Kërkon nga PZAP-i që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacion në fuqi.

PZAP-i me datën 12.11.2021, ka dërguar subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kërkesën për përgjigje në ankesë në të cilën i ka kërkuar që të përgjigjet deri me datë 12.11.2021 deri në ora 16:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 12.11.2021, Subjekti Politik LVV, konteston themelësinë e kësaj ankese për arsye se pretendimet e ankuesit të kandidatit të subjektit të tyre, Arben Vitia ka shpërndarë material zgjedhor ankuesi nuk ka arritur ta dëshmoj se me cilën datë dhe nga kush janë shpërndarë fletushkat si dhe fotot e bashkangjitura ne ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se Subjekti Politik e Lëvizja Vetëvendosje, ka shpërndarë material zgjedhor në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, janë të pabazuara, dhe nuk përbëjnë shkelje pasi që në fotografit e bashkangjitura në ankesë shihen vetëm disa vizitkarta dhe fletushka të kandidatit për Kryetar Komunes së Prishtinës Arben Vitia, të shpërndara në hyrje të banesave si dhe në rrugë. Sipas Rregullës NR.02/20215 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 5.7 ankesat duhet të kenë së paku informacione si b) *Një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin shkeljes së pretenduar*, ku në rastin konkret parashtruesi i ankesës nuk ka dhënë hollësi që të dihet se nga kush janë hedhur, në cilën datë ka ndodhur shkelja e pretenduar dhe se në cilën lagje të Prishtinës ka ndodhur shpërndarja e materialeve zgjedhore.

Andaj paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar kanë shpërndarë material zgjedhor në hapësira të palejuara konkretisht në banesa kolektive, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1111/2021 më datën 15.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.